



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE
NJËSIA E PROKURIMIT

Data: 15/ 05/ 2026

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mallra

Objekti i Procedurës: “Blerje rroba pune”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Veshje, këpucë, artikuj valixhe dhe aksesori-18000000-9. Dorashka pune-18141000-9. Kaskë sigurie - 18142000-6. Pelerina-18211000-1. Jelekë- 18235400-9. Kostume- 18222100-2.

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,136,366.68 (dy milion e njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Tiranë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në nenin 76, pika 2, gërma ”b” të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar. Njësia e prokurimit për përllogaritjen e vlerës limit të objektit të kësaj procedure prokurimi iu referua studimit të tregut për marrjen e ofertave nga subjekte të ndryshme që operojnë në treg. U përdor kjo alternativë me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut, duke marrë parasysh edhe ndryshimet e çmimeve dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Njësia e Prokurimit për procedurën në fjalë vendos që lloji i procedurës së prokurimit të jetë:
Procedurë e Hapur e thjeshtuar, mallra.

Arsyet e përdorimit të procedurës - “ E hapur e thjeshtuar”, Mallra, është sepse vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar.

Kriteret e përgjithshme të pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 2 pika “c”, nenit 78 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Funerale, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 9**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Funerale ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentim: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar) si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar): citojmë Neni 83 i LPP (i ndryshuar) “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të

vogël”, Neni 82, i LPP (i ndryshuar) “1. *Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, neni 76, 77, pika 1/a dhe 2; Nenin 25, 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe shtojcës 9 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (**2023, 2024, 2025**), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të përllogaritur**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43 pika 2/c dhe neni 55 pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar **në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të përllogaritur**, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera*

e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:
a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.

Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për këstet e maturuara për vitin **2026**, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit 9632, datë 30.10.2006 ”Per Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, për të gjitha vëndet ku operatori ekonomik ushtron aktivitet sipas Regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore të parashikuara në ligjin 9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 ne DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentim: Kërkesa e mesepërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 6, nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Per Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore”, i ndryshuar, nënigjen 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB”, i ndryshuar.

Per të vërtetuar që subjekti nuk është debitor në pagimin e taksave vendore të Qeverisjes Vendore dhe është subjekt që garanton qëndrueshmëri dhe është korrekt me detyrimet ligjore që ai ka. Janë kërkuar këstet e maturuara për vitin **2026**, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar për të siguruar konkurrencë të lirë për gjithë OE fizike apo juridike.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të

kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për këstet e maturuara për vitin **2026**, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit.** Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentim: Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”* dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia*

profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.”. Në nenin 42 pika 3 përcaktohet se: “3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme c’ka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë te Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshëm dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar në vlerën jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deklaratë që furnizimi, ngarkim-shkarkimi, transporti, do të bëhet me mjetet, puntoret dhe shpenzimet e operatorit ekonomik në destinacionin e përcaktuar nga autoritetit kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Në nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. përcaktohet se: “8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve teknike. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se, marrin përsipër realizimin e objektit të kontratës, nëpërmjet furnizimit, ngarkim-shkarkimit, transportit në destinacionin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor me mjetet, puntoret dhe shpenzimet e tyre, sipas nevojave të autoritetit kontraktor.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikimin:

a) ISO 9001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë" ose ekuivalent, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

b) ISO 14001:2015, ose e përditësuar lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është vendosur në përputhje me nenin 79 " për “Sistemin e menaxhimit të cilësisë” të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në piken 1 të nenit 44 "Kërkesat e cilësisë "të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se: “1. "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit". Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e Autoritetit kontraktor të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra AK-së .

Për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumentave të tilla si certifikata ISO e cila është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

ISO 14001 specifikon kërkesat e përgjithshme për vendosjen e një sistemi të menaxhimit mjedisor në një kompani. Ai përqendrohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të një kompanie duke e mundur atë për të përmirësuar ndikimin e performancës së përgjithshme mjedisore të kompanisë. Një organizatë mund të marrë dhe zbatojë certifikimin ISO 14001, pavarësisht nga madhësia ose qëllimi i saj. Sistemet e menaxhimit të mjedisit bazuar në ISO 14001 ofrojnë mundësinë për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar aspektet mjedisore të një organizate me qëllim :

- Parandalimit të dëmtimit të mjedisit;
- Vlerësimin të aspekteve mjedisore;
- Përmirësimin e performancës mjedisore;
- Respektimin e ligjeve;
- Ruajtjen e burimeve natyrore dhe uljen e kostos;
- Përmirësimin e imazhit të kompanisë;
- Përmirësimin e komunikimit me figurat e autoritetit.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë Autoritetit kontraktor nga një mostër fizike për artikujt me nr. rendor: (1,2,4,5,6,10,12,14,16), sipas tabelës të përcaktuar në shtojcën 7 të DST.

-Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë ‘Agjencisë së Shërbimeve Funerale’, me adresë: Rr. “Durrësit” nr.132, përballë me Ministrinë e Arsimit, Tiranë.

- Mostrat të jenë të shoqëruara me një shkresë, me listë inventarizimi dhe të identifikuar sipas numrit rendor të përcaktuar në shtojcën 7 të DST, e firmosur dhe vulosur nga ofertuesi. Mostrat duhet të kenë të ngjitur nga një etiketë e cila të përmbajë: “Emërtimin i mallit”, numrin rendor të përcaktuar në shtojcën 7 të DST, Objektin e Porcedurës, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

- Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit të mostrave të sjella me përputhshmerinë e specifikimeve të kërkuara dhe të kryejë analizat e nevojshme laboratorike nëse do të shihet e arsyeshme.

- Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin përkatës nga ofertuesi për paraqitjen e mostrave në emër dhe për llogari të tij.

Mosparaqitja e mostrave sipas kushteve të caktuara më sipër është kusht për skualifikim.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nënën të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, nënën 40, pika 6, gërma a) ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi., lidhur me të gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjesëve të tyre, punimin dhe përmasat e caktuara në specifikimet teknike. Nëpërmjet mostrave të dorëzuara, Autoriteti Kontraktor mund të kryej kontrollin e mostrave të sjella me përputhshmerinë e specifikimeve të kërkuara dhe të kryejë analizat e nevojshme laboratorike nëse do e shih të arsyeshme.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallrat objekt prokurimi katalog dhe / ose skedë teknike sipas standarteve në specifikimet teknike nga firma prodhuese, në mënyrë që të verifikohet

pajtueshmëria e specifikimeve teknike të mallrave të ofertuara me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nënën të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, nënën 40, pika 6/b, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) *Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.*

Vendosja e këtij kriteri, është në të drejtën e Autoritetit kontraktor, të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij si më sipër cituar, për të kërkuar kataloget teknik të mallrave objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike, të cilat edhe këto nga ana tjetër duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/et e prodhues/ve ose distributor/ve të autorizuar (në këtë rast duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një autorizimi mes tyre) për të gjitha mallrat objekt prokurimi për të cilat nuk është vetë prodhues. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit dhe/ose distributorit të autorizuar si: telefon, fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë prodhuesit e të gjitha mallrave objekt prokurimi me të dhënat e kontaktit.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nënit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nënit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre

mallrave. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Raport Testimi (fletë-analizë) të materialeve përbërëse të produkteve për artikujt: “*Kostume pune për burra (xhaketë+pantallona)*”, “*Përparëse pune për gra*” dhe “*Pelerinë shiu*”, “*Bluza pune pambuku me tre kopsa për gra*” e “*Bluza pune pambuku me tre kopsa për burra*”, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, të materialeve përbërëse të produkteve (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nënin të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të provuar nëse operatori ekonomik ka kapacitetet për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi nëpërmjet testimit dhe metodave të testimit. Testimi është kërkuar vetëm për këta artikuj që konsiderohen të rëndësishme për autoritetin kontraktor

8. Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë OEKO-TEX “*ose ekuivalente*” (të vlefshme), për tekstilet të prodhuesit të lëndës së parë, për tekstilet e produkteve të të gjitha veshjeve të punës. Në rastin kur lëndët e para sigurohen nga prodhues të ndryshëm, certifikata ose dokumenti ekuivalent me të, duhet të paraqitet për të gjithë prodhuesit. Për këtë OE pjesëmarrës duhet të paraqesë një autorizim nga prodhuesi i lëndës së parë ku të bëhet lidhja midis prodhuesit dhe OE/distributorit të autorizuar.

Argumentim: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Referuar specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi, gjykojmë se është e domosdoshme paraqitja e certifikatës OEKO-TEX, pasi lënda e parë e prodhuar nga subjekte të certifikuara sipas këtij standarti garanton se lënda e parë e përdorur është e padëmshme në aspektin ekologjik njerëzor, jep siguri pra nuk mbart substance të dëmshme për shëndetin e njeriut.

STANDARD 100 nga OEKO-TEX® është një nga etiketat më të njohura në botë për tekstilet e testuar për substanca të dëmshme. Ai garanton besimin e klientit dhe sigurinë e lartë të produktit.

Nëse një artikull tekstili mban etiketën STANDARD 100, konfirmon se çdo përbërës i këtij artikulli, d.m.th. çdo fije, buton dhe pajisje të tjera, është testuar për substanca të dëmshme dhe se artikulli është i padëmshëm për shëndetin e njeriut. Testi kryhet nga institutet partnere të pavarura OEKO-TEX® në bazë të katalogut të gjerë të kriterëve OEKO-TEX®.

9. OE pjesëmarrës duhet të paraqesë certificate konformiteti të rregullores EU 2016/425 ose e përditësuar, për: *“Doreza pune me veshje gome”, “Maskë mbrojtëse profesionale”, “Maskë mbrojtëse profesionale”, “Veshjet mbrojtëse integrale një përdorimshe”, “Kaskë pune sigurie, plastike PE”, “Syze mbrojtëse”,* sipas standarteve të mbrojtjes dhe sigurisë të përcaktuara në specifikimet teknike të DST. Si edhe certifikatën e modulit D sipas rregullores EU 2016/425 lëshuar në emër të prodhuesit për produktet e tekstilit të kategorisë III.

Argumentim: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në lidhje me këtë kriter, AK i është referuar një standarti ndërkombëtar, sikurse përcaktohet edhe në nenin 36 “Specifikimet teknike”, të LPP-së,...dhe kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. Duke qenë se nuk ekziston një standart konkret kombëtar, pasi standartet e harmonizuara shqiptare të miratuara shërbejnë vetëm si dokumenta me karakter refererues për prezumimin e konformitetit të pajisjeve dhe i referohen direktivës 2016/425/EU, AK i referohet rregullores së re 2016/425/EU me anë të së cilës aplikohet për procedurë verifikimi dhe certifikimi të shoqërisë prodhuese, ku vlerësohet se në modelimin apo prodhimin e këtyre artikujve respektojnë kërkesat thelbësore të përcaktuara në rregulloren 2016/425/EU në të cilën përcaktohen kërkesat minimale që duhet të përmbajnë pajisjet mbrojtëse personale, në përputhje me kriteret e përcaktuara për të konfirmuar se

pas ekzaminimit dhe certifikimit të shoqërisë, artikujt e prodhuar prej tij nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë. Vendosja e një kërkesë të tillë është në përputhje me kriteret e përcaktuara për të konfirmuar se pas ekzaminimit dhe certifikimit të shoqërisë, artikujt e prodhuar prej tij nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë e personave, kafshëve shtëpiake ose pronës (referuar rregullores). Kërkesa që artikujt objekt prokurimi të përmbushin kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara me rregulloren EU nr 425/2016 është vendosur pasi këto veshje janë prodhim për përdorim pune nga punonjës institucioni në shërbim komuniteti (pra jo përdorim personal), të cilët përballen me situatat të ndryshme vështirësie, përfshirë bakteret apo viruseve të rrezikshme, kushtet atmosferike që nuk janë të një natyre ekstreme apo kontakti me sipërfaqe të nxehta që nuk i kalojnë 50 gradë Celsius (referuar kategorive të vështirësisë të përcaktuara në rregulloren EU nr. 425/2016).

Shënim: 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

2.Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur

3. “Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe

literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.”

4. Në mbështetje të nenit 88 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’ i ndryshuar, nëse kemi bashkim operatorësh ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. ARGUMENTIM I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

1. Doreza pune me veshje gome. Doreza pune pambuku të veshura me gomë duke kaluar kycin e dorës, cilësore, që perdoruren në ndërtim dhe kopshtari. Goma të ketë dendësi të lartë, duke bërë të mundur një mbrojtje maksimale nga mjetet e forta. Veshja e gomës të jetë elastike dhe e rehatshme gjatë përdorimit. Ngjyra e dorezave të jetë e errët.

2. Doreza pune lëkure, ndërtimi. Doreza pune lëkure profesionale, cilësore, të prodhuara me një formë të gjatë duke kaluar kyçin e dorës, për të siguruar një mbrojtje sa më të mirë për specialistët në fushën e ndërtimit. Në sajë të materialit prej lëkure të dendur, krijojnë siguri në punë duke i mbrojtur gjatë punës.

3. Bluzë pune pambuku me tre kopsa për (gra) (logo). Materiali të jetë 100% pambuk, Peshë: 180-200 gr/m², me tre kopsa me jakë dhe mëngë të shkurtra. Logo do të jetë sipas modelit bashkëlidhur. Ngjyra e negociueshme midis blu e errët dhe jeshile.

4. Bluze pune pambuku me tre kopsa për (burra) (logo). Materiali të jetë 100% pambuk, Peshë: 180-200 gr/m², me tre kopsa me jakë dhe mëngë të shkurtra. Logo do të jetë sipas modelit bashkëlidhur. Ngjyra e negociueshme midis blu e errët dhe jeshile.

5. Kostume pune për burra (pantallona+xhaketa) (logo).

a) Xhaketa

Materiali të jetë 65% polyester dhe 35% pambuk, peshë 240-280 gr/m², cilësi e lartë. Xhaketa ka dy xhepa të pjerrët me fileto në pjesën e poshtme dhe dy xhepa pllakë në pjesën sipër. Mbyllja e xhaketes do të jetë me zinxhir i cili mbulohet nga një copë mostër dhe me percina. Xhaketa do të jetë

me mëngë të gjata, të cilat të jenë të pajisura me manshetë të mëngët dhe në pjesën fundore. Xhaketa në gjithë perimetrin e gjoksit dhe mbrapa duhet të jetë e pajisur në një filetë kordon të hollë fosforeshente me gjerësi 0.5-1 cm. Gjatësia e xhaketës do të jetë sipas standarteve të xhaketave të kostumeve klasike dhe jo më e shkurtër. Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 40°C. Logo do të jetë sipas modelit bashkëlidhur. Ngjyra e negociueshme midis blu e errët dhe gri e errët.

b) Pantallonat

Materiali të jetë 65% polyester dhe 35% pambuk 240-280 gr/m², cilësi e lartë. Në pjesën e përparme do të kenë dy xhepa të pjerrët. Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 40°C. Ngjyra e negociueshme midis blu e errët dhe gri e errët.

6. Jelekë fosfori (logo). Jeleku është i përbërë nga material 100% poliester. Me shirit 5cm fosforeshent në pjesën e përparme dhe në pjesën e pasme, për të bërë të mundur parandalimin e aksidenteve. Jeleku të ketë të stampuara logon të dukshme. Logo do të jetë sipas modelit bashkëlidhur.

7. Maskë mbrojtëse profesionale. Maska mbrojtëse profesionale është me filtër të valvulave të frymëmarrjes. Filtri i dizajnit 3D me anti-virus, anti pluhur me efikasitetit të lartë me 4 shtresa, . Modeli i përshtatshëm dhe i rregullueshëm 3D i urës së hundës. Maskë respiratore, me një përdorim, hipoalergjike, pa fibra qelqi, përshkueshmëri të mirë të ajrit, me nivel filtrimi të ajrit $\geq 95\%$, e përputhshme me fytyrën dhe hundën.

8. Maska mbrojtëse me tre shtresa 50 copë/pako. Maska mbrojtëse me 3 shtresa është e shkëlqyeshme për mbrojtjen e njerëzve nga poleni, bakteret, alergjenet, pluhuri, kimikatet dhe tymi. Përmban një tel në pjesën e hundës të rregullueshëm për të siguruar një përshtatje perfekte. Shtresa e brendshme është bërë nga inde të buta, pa ngjyrosje, të butë për lëkurën.

9. Veshje mbrojtëse integrale njëpërdorimshme. Veshje të përshtatshme njëpërdorimshme sipas standartit të mbrojtjes së sigurisë në punë. Veshje komplet me kapuç. Veshje personale, jo të endura, Materiali të jetë i papërshkrueshëm nga lengjet, mbrojtje nga viruset dhe bakteret, të ketë qëndrueshmëri të lartë. Lloji i materialit polipropilen/polietilen (PP/PE).

10. Çizme për burra. Çizmet me material 100% PVC me qafë të gjata deri afër gjurit, të jenë të padepërtueshme nga uji dhe shollë me lule. Ti rezistojnë ndryshimeve të temperaturës në ambientin e punës. Ato mund të përdoren në fushat e ndërtimit si dhe të bujqësisë. Cilësi e lartë.

11. Çizme për gra. Çizmet me material 100% PVC me qafë të gjata deri afër gjurit, të jenë të padepërtueshme nga uji dhe shollë me lule. Ti rezistojnë ndryshimeve të temperaturës në ambientin e punës. Ato mund të përdoren në fushat e ndërtimit si dhe të bujqësisë. Cilësi e lartë.

12. Përparse pune për gra (logo). Materiali të jetë 65% polyester dhe 35% pambuk. Pesha: 240-280 gr/m². Të ketë jakë, hapja para dhe mbërthimi me kopsa. Në pjesën e përparme të saj të ketë dy xhepa dopi pllakë dhe sipër një xhep në krahun e majtë. Përparset të jenë me mëngë të gjata dhe me

gjatësi të trupit deri afër gjurit. Logo do të jetë sipas modelit bashkëlidhur. Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 40°C. Ngjyra e negociueshme midis blu e errët dhe jeshile.

13. Kaskë pune sigurie, plastike PE. Kapele që përdoren në industri dhe ndërtim, materiali plastike. Aftësi mbrojtje kundër çarjeve, absorbimi i goditjeve, anti-shok, peshë e lehtë, fortësi e rezistencë të lartë. Peshë e skeletit: 300 gr. Peshë e veshjes së brendshme: 90 gr, 4 pika fiskuese, mënyrë manuale e rregullimit në pjesën e rripit të kokës.

14. Këpucë mbrojtëse me qafa. Këpucë mbrojtëse me qafë të gjatë, që përdoren në ndërtim. Këpucët të jenë material lëkure, të janë të pajisura me shtresë metalike në pjesën e poshtme dhe pjesën e përparme, gjë që i siguron këmbës një mbrojtje maksimale kundër dëmtimeve gjatë punës me gozhdë, vida, dhe peshave të ndryshme që mund të bien mbi këmbë. Veshja e tyre e brendshme të jetë me sfungjer.

15. Syze mbrojtëse. Të përbëra nga plastikë e cilësisë së lartë, me rezistence maksimale ndaj goditjeve. Sigurojnë mbrojtjen e syve dhe pjesëve jetësore rreth syrit nga materialet që lëvizin me shpejtësi të lartë gjatë punimit në konstruksione metalike apo në fushën e ndërtimit. Përveç pjesës plastike mbrojtëse në sy të kenë mbrojtës plasike edhe në ane dhe me bisht. Materiali do të jetë plastike, ngjyra transparente.

16. Pelerinë shiu (logo). Materiali të jetë 62% polyester dhe 38% polyamide. Peshë: 180-200 gr/m². Tekstil i gomuar mospërshkrueshmëria nga uji 100%. Pelerina do të jetë e gjatë deri poshtë gjurit me mëngë të gjata dhe me kapuç. Mbyllja të jetë me zinxhir nga brenda dhe percina nga jashtë dhe me dy xhepa në pjesën e përparme në secilën anë. Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 30°C. Logo do të jetë sipas modelit bashkëlidhur.

Bashkëlidhur është edhe logo për veshjet për të cilat është kërkuar vendosja e logos.

Për sa i përket masave të rrobave të punës, operatori ekonomik fitues do të bëjë matjen e punonjësve në bashkëpunim me Autoritetin kontraktor në fillim të zbatimit të kontratës.

Argumentimi i specifikimeve teknike: Specifikimet teknike në përputhje me Nenin 16, “Sektorët e varrezave Sharrë dhe Tufinë”, dhe nenin 17 “Sektori i Varrezave në Njësitë Administrative”, në rubrikën “Detyrat dhe përgjegjësitë” e punëtorëve në varësi të Përgjegjësive të Sektorëve të Varrezave Sharrë, Tufinë dhe të Njësisive Administrative të Urdhërit nr.27381/1, datë 8.8.2022, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, “Për miratimin e rregullores, për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Shërbimeve Funerale, Institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose

originë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

III. SASISA DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Pershkrimi i mallit	Njesia	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Doreza pune me veshje gome	palë	324	Magazina e institucionit	30 ditë
2	Doreza pune lëkure, ndërtimi	palë	324	Magazina e institucionit	30 ditë
3	Bluze pune pambuku me tre kopsa vere për gra	copë	59	Magazina e institucionit	30 ditë
4	Bluze pune pambuku me tre kopsa vere për burra	copë	103	Magazina e institucionit	30 ditë
5	Kostume pune për burra	kostume	103	Magazina e institucionit	30 ditë
6	Jelek fosfori	copë	163	Magazina e institucionit	30 ditë
7	Maska mbrojtëse profesionale	copë	40	Magazina e institucionit	30 ditë
8	Maska mbrojtëse me tre shtresa 50 copë/pako	pako	60	Magazina e institucionit	30 ditë
9	Veshje mbrojtëse integrale njëpërdorimëshe	copë	20	Magazina e institucionit	30 ditë
10	Çizme për burra	palë	103	Magazina e institucionit	30 ditë
11	Çizme për gra	palë	59	Magazina e institucionit	30 ditë
12	Përparse pune për gra	copë	59	Magazina e institucionit	30 ditë
13	Kaskë pune sigurie, plastike PE	copë	163	Magazina e institucionit	30 ditë
14	Këpucë mbrojtëse me qafa	palë	162	Magazina e institucionit	30 ditë

15	Syze mbrojtëse	copë	30	Magazina e institucionit	30 ditë
16	Pelerinë shiu	copë	165	Magazina e institucionit	30 ditë

Afatet e lëvrimit:

Afatet e lëvrimit: Afati i lëvrimit është 30 ditë duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.



Logo: Stema e Bashkisë Tiranë dhe në anë mbishkrimi “BASHKIA TIRANË” dhe poshtë tij mbishkrimi “SHËRBIMI FUNERAL”, sipas modelit të mësipërm për veshjet, për të cilat është kërkuar vendosja e logos. Meqënëse ngjyrat e veshjeve për të cilat është kërkuar logo janë të errëta, ngjyra e shkrimit do të jetë e bardhë, ndërsa stema e bashkisë me ngjyra.